

VENDIM
Nr. 29, datë 16.2.2023

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË
NIVELIN E TENSIONIT 20/10/6 kV, PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.2.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 573/1 prot., datë 13.2.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin janar 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për vitin 2023”,

konstatoi se:

- Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 820/1 prot., datë 7.2.2023, protokolluar me tonën me nr. 572/1 prot., datë 7.2.2023, ka paraqitur aplikimin për miratimin e çmimit të energjisë elektrike prej 18,34 lekësh/kwh për muajin janar 2023, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1 janar 2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Referuar kërkesës së sipërcituara të FSHU sh.a. evidentojmë, se: shoqëria vijon të kërkojë përfshirjen e kostove të disbalancave në përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, ndërkohë që ERE, në të gjitha vendimmarrjet e mëparshme, por edhe me anë të shkresës nr. 2030/1 prot., datë 14.12.2022, ka sqaruar FSHU sh.a., se: “... Në kuptim të nenit 6, pika 3 dhe pika 5, të ‘Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit’, miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, të ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë për periudhën e livrimit, mbi të cilën do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga rregullatori. Sikurse përcaktohet në metodologji, kostot e imbalancave (zë i emërtuar nga shoqëria si disbalanca) do të llogariten dhe faturohen, në përputhje me përcaktimet e rregullave të tregut dhe akteve të tjera në fuqi”, duke kërkuar ndaj shoqërisë që të marrë në konsideratë vetëm komponentët e njohur dhe të përfshirë në formulën e përcaktuar në metodologji.

- Mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a., çmimi mesatar i ponderuar për blerjen e energjisë elektrike nga KESH sh.a. për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për vitin 2023 do të jetë 12.00 lekë/kwh.

- Referuar, gjithashtu, shkresës së shoqërisë KESH sh.a. me nr. 6258/5 prot., datë 20.1.2023, evidentojmë, se: Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të KESH sh.a., në zbatim të parashikimeve të pikës 2, të nenit 5, të vendimit nr. 456, datë 29.6.2022, miratoi me vendimin e datës 4.1.2023, programin ekonomiko-financiar të KESH sh.a., duke përcaktuar furnizimin me të gjithë sasinë e nevojshme të energjisë për klientët universalë, përfshirë këtu edhe klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, të cilët kanë dalë në treg të parregulluar nga data 1.1.2022 dhe aktualisht furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 20/10/6 kV në zbatim të vendimit të Bordit të ERE nr. 324, datë 14.12.2022, i cili la në fuqi vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022, vijon të jetë 3.99 lekë/kwh.

- Vlerësohet se komponentët e përlogaritjes së çmimit të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh janë konstantë për aq kohë sa kostoja e blerjes së energjisë elektrike nga shoqëria KESH sh.a., me qëllim mbulimin e kërkesë së kësaj kategorie klientësh, mbetet e pandryshuar. Në të tilla kushte çmimi i shitjes së energjisë i kalkuluar më poshtë mbetet i njëjtë për të gjithë periudhën 1.1.2023–31.12.2023.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, aplikimeve të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2023 janë përlogaritur, si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për nivele tensioni për muajin Janar 2023			
JANAR 2023		Nivelet e tensionit	
		35 kV	20/10/6 kV
	Njësia	Çmimi	Çmimi
CBEt	Blerja e energjisë elektrike	Leke/kWh	27.97
Pr	Kthimi për rrishtin i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.84
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA		Leke/kWh	32.27
			18.26

- Mbështetur në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimet e shoqërisë, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë:

- 18.26 lekë/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për periudhën 1.1.2023–31.12.2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për periudhën 1.1.2023–31.12.2023, prej 18.26 lekësh/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Çdo ndryshim në elementet përbërëse të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

